

V E N D I M
Nr.34 datë 25.1.1993

PËR RRITJEN E NDIHMAVE EKONOMIKE

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 datë 7.10.1968 "Për ndihmën ekonomike personave të paafte për punë që nuk kanë të ardhura dhe që janë pa ndihmë", bëhen këto ndryshime:

- Shkronja "c" e pikës 1 ndryshohet si vijon:

"Për raste të veçanta kur shikohet e arsyeshme, me miratim të Këshillit të Bashkisë apo Komunës, mund t'u jepet ndihmë personave të tjerë e atyre që ndërpresin pagesën e papunësisë dhe që janë në kondita shumë të vështira ekonomike".

- Pika 2 ndryshohet si vijon:

"masa e ndihmës të jetë deri 270 lekë në muaj për frymë (ku është përfshirë dhe rritja prej 50 për qind, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.385, datë 24.10.1991)".

2. Ndihma e përhershme mujore që merr i strehuari i huaj sipas pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.59, datë 18.3.1983 të rritet edhe 18 për qind mbi rritjen që është bërë në pikën 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 29.10.1992 "Për rritjen e pensioneve, të përkrahjes sociale dhe të ndihmave ekonomike".

3. Pika 4 e vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.465, datë 29.10.1992 "Për rritjen e pensioneve, të përkrahjes sociale dhe të ndihmave ekonomike", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi me 1 shkurt 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Mexsi